



Nr. 1 prot.

Tiranë, më 09 / 03 /2020.

VENDIM

Nr. 1, Datë 09 / 03 /2020

“PËR KONSTITUIMIN E KOMISIONIT INSTITUCIONAL ZGJEDHOR (KIZ)”

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", urdhrin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 8, dt. 14.01.2020 "Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë" dhe Rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe senatin akademik në Universitetin e Arteve"; miratuar me vendim të Senatit Akademik, Nr. 19, dt. 10.02.2020, sot më datë 09.03.2020, u mbledhën:

Z. Orges Malaj	Përfaqësues nga Fakulteti i Muzikës;
Znj. Suela Agolli	Përfaqësues nga Fakulteti i Artit Skenik;
Z. Ergys Krisiko	Përfaqësues nga Fakulteti i Arteve të Bukura;
Z. Albjon Begaj	Përfaqësues i Studentëve të UART;
Z. Ted Kamberi	Juristi i UART;
Znj. Armira Kapxhiu	Sekretar i Komisionit Institucional të Zgjedhjeve,

për konstituimin e Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ). Në këtë mbledhje të parë komisioni vendosi zgjedhjen e Znj. Suela Agolli, Kryetare të KIZ.

Z. Orges Malaj

Z. Ergys Krisiko

Z. Ted Kamberi

Znj. Suela Agolli

Z. Albjon Begaj

SEKRETARE

Znj. Armira Kapxhiu

